



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:076223

Datë: 30.04.2019

Numri i dokumentit: 00294820

P.nr.200/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Sabedin Mushica, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Igballe Azemi, në çështjen penale ndaj të pandehurit A. S. nga Gjilani, për shkak të veprës penale, lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-ës, të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokat Nasuf Nasufi, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.263/2019, të datës 28.02.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 11.03.2019, mori dhe shpalli, ndërsa e përpiloi me datë 02.04.2019, këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri A. S., nga babai ..... dhe nëna N....., e lindur Sahiti, i lindur me datë 27.02.1978 në Gjilan, ku edhe jeton, Rruga “.....”, numër 12, si dhe me vendbanim në Minhen të Gjermanisë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 16.02.2019, rreth orës 21:35 minuta, në rrugën “Lidhja e Prizrenit”, në Gjilan saktësisht te kafiteria “.....”, i pandehuri pas një mosmarrëveshje fillimisht verbale me të dëmtuarin, K..... L.....-kamarier i cili i ka shërbyer me një pije të porositur, të njëjtin e sulmon edhe fizikisht, duke e godit me grusht në pjesën e fytyrës nën syrinë majtë, me ç’rast të njëjtit i shkakton lëndi të lehtë trupor i cili për shkak të lëndimit trupor detyrohet të kërkojë ndihmë mjekësore në Emergjencën e Spitalit Regjional të Gjilanit

-Me çka ka kryer veprën penale, lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4,41,42,43, 46, 73,74 dhe 75 të KPRK-ës, lidhur me nenin 248 dhe 365 të KPPRK-ës, të pandehurit i shqipton:

## DËNIM ME GJOBË

Ashtu që i pandehuri A. S., dënohet me dënim me gjobë në shumë prej 600€(gjashtëqind)euro, të cilën do ta paguajë, në afat prej 3 muajve, pas ditës pasuese të plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata do të cakton 1(një)ditë burgim për çdo 20 € (njëzetë) Euro, të dënimit me gjobë.

Koha e kaluar në paraburgim edhe atë prej datës17.02.2019 deri më datën 11.03.2019, të pandehurit do t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar me gjobë, në atë mënyrë që çdo 20 € (njëzetë Euro) të dënimit me gjobë do të barazohen me 1 (një) ditë të qëndrimit në paraburgim.

Të pandehurit masa e paraburgimit i është caktuar me aktvendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake të kësaj gjykate PPr.nr.28/2019 të datës 19.12.2019 në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji, ashtu që me datë 11.03.2019, e njëjta masë i ndërprehet.

Detyrohet i pandehuri që ta paguajnë paushallin gjyqësor në shumë prej 30(tridhjetë)euro dhe 30 (tridhjetë) euro, në emër të kompensimit e viktimave të krimit, si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

## A R S Y E T I M

### 1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjiilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 01.03.2019 në këtë gjykatë ka dorëzuar aktakuzën me numër, PP.II.nr.263/2019 të datës 28.02.2019, ndaj të pandehurit A. S., për shkak të veprës penale, lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-ës.

Me datë 11.03.2019, gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën kanë prezantuar prokurorja e shtetit Ismet Ukshini, i dëmtuari Kastriot Limani<sup>1</sup>, i pandehuri A. S. me mbrojtësin e tij, avokat N. N., në të cilën seancë i pandehuri pas leximit të akt akuzës nga ana e prokurorit, ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale, kanosje nga neni 185 paragrafi 2 e nenin 31 të KPRK-ës.

### 2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë në kuptim të nenit 248 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të KPP-ës.

---

<sup>1</sup> Nuk i është bashkangjitur ndjekjes penale dhe ka deklaruar se nuk do të paraqes kërkesë pasurore juridike ngase janë pajtuar me familjen e të pandehurit

Në këtë aspekt gjyqtari ka konstatuar se i pandehuri, e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i akuzuari nuk kanë qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojnë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

### 3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri i i alrtckeur, e ka kryer veprën penale të lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4, të KPRK-ës, në kohën vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

### 4.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenit 248 të KPP-ës, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit të lartcekur dhe të njëjtit, i'u shqiptoi dënim me gjobë në shumë prej 600 euro të cilën do ta paguajë në afat prej 3 muajve nga dita plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, i cili dënim do të jetë i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale.

Gjyqtari me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 73,74 dhe 75 të KPRK-së ashtu që si rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, se i njëjti është penduar dhe ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryejë vepra tjera penale, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata e ka marrë për bazë mënyrën e kryerjes së veprës penale, ku i pandehuri të dëmtuarin godet ne vendin e tij të punës.

### 5.Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit të lartcekur, duke i marr parasysh rrethanat lartpërmendura është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, me mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe shkallën e përgjegjësisë së tyre.

Gjyqtari po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin i tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

### 6.Llogaritje e arrestit shtëpiak në dënimin e shqiptuar

Në 83 paragrafi 1 të KPRK-ës parashihet se “*Koha e kaluar në paraburgim, arrest shtëpiak si dhe çdo periudhë e heqjes së lirisë lidhur me veprën penale llogariten në dënimin e shqiptuar me burgim dhe me gjobë*”, andaj në rastin konkret i pandehuri A. S. ka qëndruar nën masën e paraburgimit edhe atë nga data 17.02.2019 deri me datë 11.03.2013, dhe gjykata ia llogaritë në dënimin e shqiptuar me gjobë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në atë mënyrë që çdo 20 € të dënimit me gjobë do të barazohen me një ditë të masës së paraburgimit.

### 7.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale, gjyqtari i vetëm gjykues duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-ës, ka vendosur që të pandehurin ta obligojë ti paguajë shpenzimet procedurale sipas përlogaritjes përfundimtare nga ana e gjykatës dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 30 euro, si dhe shumën prej 30 euro, për kompensimin e viktimave të krimit edhe atë në kuptim të nenit 39 paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensim e Viktimave të Krimit, në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
P.nr.200/2019,  
Me datë 02 prill 2019

Sekretarja juridike,  
Igballe Azemi

Gjyqtari i vetëm gjykues  
Sabedin Mushica

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.

Numri i lëndës: 2019:076223  
Datë: 30.04.2019  
Numri i dokumentit: 00294820